REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E ARSIMIT PARASHKOLLOR,RINISE DHE SPORTIT

Nr._____Prot . **Bilisht, më / /2026**

PROJEKT-VENDIM

NR 46 /DATË 21 / 05 /2026

PËR

"DHENIEN E ÇERTIFIKATES TE MIRENJOHJES Z. ADMIR BITINCKA "

Në mbështetje të nenit 54 germa "m" të Ligjit Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ", Ligjit Nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Vendimi nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë" dhe kërkesës të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendor të Nderit.

PROPOZOJ:

1.Dhenien e Çertifikates te Mirenjohjes , për z. **Admir Bitincka** .

2.Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise Devoll.

3.Ky vendim do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139 data 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Konceptoi :
Drejtor i Drejtorisë të Arsimit Parashkollor,Rinisë dhe Sportit.
E.Pavliqoti

Konfirmoi bazën ligjore:Specialist jurist
J.Sancolli

Konfirmoi Sekretari i Përgjithshëm:
A. Rushitaj

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E ARSIMIT PARASHKOLLOR,RINISE DHE SPORTIT

Nr 1838 **prot** **Bilisht,** 19 /05/ **2026**

RELACION

"Për dhenien e "Çertifikates te Mirenjohjes" Z, Admir Bitincka me motivacionin :"**Per kontributin e dhene per permiresimin e infrastruktures ne shkollen "Hasan Bitincka " Bitincke** "

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Devoll.

Te nderuar anetare te Keshillit Bashkiak:

Drejtoria e Arsimit Parashkollor Rinise dhe Sportit ka marre kërkesën me nr 1557 Prot date 30.04.2026 te depozituar nga anetari i Keshillit z. Valbona Spaho për dhenie "Certifikate Mirenjohje ' Z, Admir Bitincka me motivacionin "**Per kontributin e dhene per permiresimin e infrastruktures ne shkollen "Hasan Bitincka " Bitincke** "

Bazuar ne relacionin e dhene nga Drejtori i Shkolles Bitincke si dhe ne dijenine tone si Bashki, Z.Admir Bitincka dhe familjaret e vet kane dhene nje kontribut te madh ne veren e vitin 2024 per Shkollen Bitincke duke bere te mundur:

- **pajisjen e laboratorit e TIK me 8 kompjutera** , duke rritur cilesise e mesimdhenies ne shkolle.

- **rikonstruktimin e plote te tualeteve te shkolles** , duke permiresuar ndjeshem higjenen ne shkolle.

- **shtrimin me pllaka ne rrugen hyrese te shkolles** duke permiresuar ndjeshem aksesin dhe ambientin shkollor .

Z, Bitincka ka treguar gadishmerine per te vijuar me investime te tjera ne kete shkolle dhe per vite te ardhshme .

Kontributi i tij dhe familjes ka ndikuar drejtperdrejt ne permiresimin e mjedisit arsimor per nxenesit dhe mesuesit e shkolles

Ky akt i larte qyteterie meriton te vleresohet publikisht , prandaj ne i propozojme Keshillit te Bashkise qe ta vleresoje me 'ÇERTIFIKATE MIRENJOHJE» Z. Admir Bitincka .

Bashkengjitur ketij relacioni keni kerkesen me nr 1557 prot date 30.04.2026.

Adresa: LagjaNr. 1, Rr. 24 TetoriNr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

Ftojme te gjithe anetaret e Keshillit Bashkiak te gjykojne dhe te vendosim ne baze te detyres qe i ngarkon Ligjit te miratojne ose jo kete Projekt-Vendim te propozuar nga Drejtoria e Arsimit Parashkollor, Rinise dhe Sporteve , ne baze te kerkeses te depozituar ne protokoll.

Konceptoi :Drejtore e Drejtorise te Arsimit Parashkollor Rinise dhe Sportit

Eliverta Pavliqoti

Adresa: LagjaNr. 1, Rr. 24 TetoriNr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

Data: 30.04.2026

KËRKESË PËR DHËNIEN E CERTIFIKATËS SË MIRENJOHJES

Drejtuar: Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkise DEVOLL

Të nderuar kolegë,

Në cilësinë time si Këshilltare në Këshillin Bashkiak dhe njëkohësisht si Drejtoreshë e Shkollës "Hasan Bitincka"Bitincke, kam kënaqësinë të paraqes këtë propozim për dhënien e një Certifikate Mirënjohjeje për z. Admir Bitincka, trashëgimtar i Hasan Bitinckës, emrin e të cilit mban shkolla jonë.

Z. Admir Bitincka, së bashku me nipër e mbesa të tjerë të familjes, ka realizuar një kontribut të jashtëzakonshëm në përmirësimin e infrastrukturës së shkollës, duke sjellë:

- 8 kompjutera për pajisjen e laboratorit të TIK, duke rritur ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe mundësitë për zhvillimin teknologjik të nxënësve;
- Rikonstruktimin e plotë të banjave, duke siguruar kushte higjienike dhe dinjitoze për gjithë komunitetin shkollor;
- Shtrimin me pllaka të rrugës hyrëse të shkollës, duke përmirësuar aksesin dhe pamjen e ambientit shkollor.

Ky angazhim është jo vetëm një akt qytetar, por edhe një shprehje e thellë e respektit ndaj trashëgimisë familjare dhe ndaj komunitetit tonë arsimor. Për më tepër, z.A. Bitincka ka shprehur gatishmërinë për të vijuar me investime të tjera, gjë që e bën këtë bashkëpunim edhe më të vlefshëm për të ardhmen.

Kontributi i tij ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mjedisit mësimor dhe ka ndihmuar në krijimin e një atmosfere më të përshtatshme për nxënësit dhe stafin pedagogjik. Ky akt i lartë qytetarie dhe përkushtimi ndaj arsimit meriton të vlerësohet publikisht.

Për këtë arsye, ju lutemi të shqyrtoni mundësinë e dhënies së një certifikate zyrtare mirënjohjeje nga ana e Këshillit Bashkiak, si shenjë respekti dhe nxitje për bashkëpunime të mëtejshme me komunitetin.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme.

Me respekt dhe mirënjohje,

Valbona Spaho

Këshilltare në Këshillin Bashkiak Devoll

Drejtore e Shkollës "Hasan Bitincka"Bitincke

RELACION MBI KONTRIBUTIN E Z. ADMIR BITINCKA NË SHKOLLËN "HASAN BITINCKA"

Shkolla "Hasan Bitincka" është një institucion arsimor me rëndësi të veçantë për komunitetin tonë, jo vetëm për rolin e saj edukues, por edhe për lidhjen historike me figurën e Hasan Bitinckës, një personalitet i nderuar i zonës. Emri i shkollës bart një trashëgimi që meriton respekt dhe përkujdesje të vazhdueshme.

Në këtë kontekst, z. Admir Bitincka, trashëgimtar i Hasan Bitinckës, ka ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete për përmirësimin e kushteve të shkollës, duke treguar përkushtim dhe ndjenjë të thellë përgjegjësie ndaj trashëgimisë familjare dhe komunitetit arsimor.

Z.Admir Bitincka ka lindur ne Korçë me 18.10.1948. u rrit dhe edukua ne nje familje me tradita patriotike dhe atdhedashese.ka mbaruar studimet per inxhinieri mekanike. Kapunuar fillimisht si tornitor , inxhinier dhe me pas si kryeinxhinier ne Parkun e Mallrave ne Korce. Ne vitin 2002 emigroi me familjen ne USA .i edukuar me ndjenjen e patriotizmit dhe traditen familjare ka qene me mendje dhe zemer I lidhur me vendlindjen.Eshte ndjere teper I vleresuar per ate cka bere fshati Bitincke duke I vene emrin shkolles "Hasan Bitincka".i obliguar per kete se bashku me djemte e tij, me nipër e mbesa të tjerë të familjes Bitinck a,te cilet jetojne ne Tirane,gjatë vitit shkollor 2023-2024, z. Admir Bitincka, së, ka realizuar këto investime në shkollën "Hasan Bitincka" me deshiren e madhe qe stafi mesimor dhe nxenesit e kasaj shkolle te mesojne dhe studjojne ne nje ambientedukuesdhe bashkekohor

- Donacioni i 8 kompjuterëve, të cilët janë vendosur në laboratorin e informatikës dhe po përdoren aktivisht nga nxënësit dhe mesuesit per realizimin e programit mesimor dhe zhvillimin e aftësive digjitale

- Rikonstruktimi i plotë i banjave të shkollës, duke përfshirë instalime të reja hidraulike, pajisje sanitare dhe përmirësime të ndjeshme në higjienë dhe funksionalitet.

- Shtrimi me pllaka i rrugës hyrëse të shkollës, duke përmirësuar ndjeshëm aksesin për nxënësit, prindërit dhe stafin, si dhe duke rritur estetikën e ambientit shkollor.

Gjithashtu, z.A Bitincka ka shprehur gatishmërinë për të vijuar me investime të tjera, në varësi të nevojave që mund të paraqiten në të ardhmen.

Vlera dhe ndikimi i kontributit

Kontributi i z. Admir Bitincka ka sjellë përfitime të drejtpërdrejta për:

- Nxënësit, të cilët tashmë kanë akses në teknologji moderne dhe ambiente më të sigurta.
- Stafin pedagogjik, që punon në kushte më të mira dhe me mjete më efikase.
- Komunitetin lokal, që sheh një institucion më të mirëmbajtur dhe më të respektuar.

Ky angazhim është një shembull frymëzues i bashkëpunimit mes qytetarëve dhe institucioneve arsimore, dhe meriton të vlerësohet publikisht.

Përfundim dhe rekomandim

Duke marrë parasysh natyrën dhe vlerën e kontributit të z. Admir Bitincka, si dhe lidhjen e tij të veçantë me shkollën "Hasan Bitincka", rekomandohet:

- Dhënia e një Certifikate Mirënjohjeje nga Këshilli Bashkiak, si shenjë respekti dhe nxitje për angazhime të ngjashme në të ardhmen.
- Organizimi i një ceremonie simbolike në ambientet e shkollës, ku të bëhet dorëzimi i certifikatës dhe të shprehet publikisht mirënjohja e komunitetit.

Me respekt,

Valbona Spaho

Këshilltare në Këshillin Bashkiak Devoll

Drejtore e Shkollës "Hasan Bitincka"Bitincke

LIGJ
Nr. 139/2015

PËR VETËQEVERISJEN VENDORE

Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Administrimi" është e drejta për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e një funksioni.
2. "Autonomi vendore" është e drejta dhe aftesia e njësive të vetëqeverisjes vendore, te krijuara sipas Kushtetutës dhe ketij ligji dhe ne kuader te kufizimeve te tij, qe te rregullojne dhe te administrojnë nje pjese thelbësore te ceshtjeve publike nen pergjegjesine e tyre dhe ne interes te bashkësisë.
3. "Funksion" është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.
4. "Funksione të deleguara" janë ato funksione të qeverisë qendrore, ushtrimi i të cilave u delegohet njësive të vetëqeverisjes vendore.
5. "Kompetencë" është autoritet i dhënë me ligj një organi të njësive të vetëqeverisjes vendore për kryerjen e një funksioni apo një pjese të tij.
6. "Konsultimi" është proces institucional këshillimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, transparent dhe i drejtpërdrejtë, për informimin, këshillimin e shkëmbimin e opinioneve për politikat, legjislacionin e normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore, i cili zhvillohet rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme, sipas procedurave dhe një strukture të përcaktuar.
7. "Ndërmarrje për shërbime publike" është çdo ndërmarrje e krijuar për të ofruar shërbim /shërbime publik/e që janë kompetencë e bashkisë, për të cilën kapitali, vota ose e drejta për të emëruar organet drejtuese dhe financimi kontrollohen nga bashkia.
8. "Qeverisje qendrore" është Këshilli i Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të shtetit.
9. "Rregullimi" është e drejta për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin.

6. Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm bashkiak ushtron kompetenca të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste të situatave emergjente.

7. Mbledhja e këshillit bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 55 të këtij ligji.

8. Mbledhjet e këshillit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Mënyra e mbajtjes së procesverbalit dhe e vërtetimit të tij përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;

b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;

c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;

ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;

dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;

e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;

ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;

f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;

g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;

gj)vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;

h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;

i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;

j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;

k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

l) vendos për simbolet e bashkisë;

ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;

m) jep tituj nderi dhe stimuj;

n)vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.

Neni 55

Votimi

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur.